



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

RREGULLORE
PËR PROCEDURAT E THEMELIT DHE FUNKSIONIMIT TË
KËSHILLIT TË VEPRIMIT RINOR LOKAL NË KOMUNËN E
PODUJEVËS

Podujevë
28 dhjetor 2016



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Në bazë të neneve 12 paragrafi 12.2 shkronja c, 17 shkronja r, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenit 10 të Ligjit nr.03/L-145 për fuqizimin dhe pjesëmarrje të rinisë, nenit 17 të Udhëzimit Administrative nr.09/2010 për përgjegjësitë dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillave të Veprimit Rinor në Kosovë dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja b të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.01. Nr. 110-391, Kuvendi i Komunës së Podujevës në mbledhjen e mbajtur më 28 dhjetor 2016, miratoi këtë,

RREGULLORE

PËR PROCEDURAT E THEMELIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT TË VEPRIMIT RINOR LOKAL NË KOMUNËN E PODUJEVËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë procedurat e themelimit, përfaqësimit, detyrat, përgjegjësit, funksionimin, burimet financiare dhe mbështetja financiare, procedurat e ankesave dhe shpërbërjes së Këshillit të Veprimit Rinor Lokal, në tekstin e mëtejshëm KVRL.

Përkufizimet

Neni 2

Në këtë rregullore, termat në vijim e kanë kuptimin:

Udhëzimi Administrativ - nënkupton Udhëzimin Administrativ nr. 9/2010 për përgjegjësinë dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillave të Veprimit Rinor të Kosovës.

Drejtoria - nënkupton Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Zyrtar rinor - nënkupton zyrtarin përgjegjës për Rini në Komunë:

KVRL - nënkupton Këshillin e Veprimit Rinor Lokal.

Kuvendi i KVRL-së - nënkupton Kuvendin, forum përfaqësues i organizatave rinore anëtare të KVRL-së.

Akti i themelimit - nënkupton aktin me të cilin përcaktohet numri i organizatave rinore të cilat e përbëjnë anëtarësinë e Këshillit.

II. DISPOZITAT E VEÇANTA

Themelimi i KVRL-së

Neni 3

1. Zyrtari rinor fton me ftesë publike organizatat dhe grupet tjera rinore të Komunës për krijimin e Këshillit iniciues për themelimin e KVRL-së.
2. Këshilli iniciues përgatit mbajtjen e Kuvendit për themelimin e KVRL-së.
3. Kuvendi autorizon Bordin Ekzekutiv për hartimin e Statutit dhe të Rregullores së punës të KVRL-së.
4. Pas miratimit të Statutit dhe Rregullores së punës në Kuvend, Bordi Ekzekutues bën kërkesën për regjistrimin, sipas dispozitave ligjore për organizatat jo fitimprurëse.
5. Pas regjistrimit, në pajtim me dispozitat e nenit 13 të Udhëzimit Administrativ, KVRL bën kërkesë me shkrim për njohje në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Përfaqësimi

Neni 4

Përfaqësimi i organizatave dhe grupeve rinore në KVRL bëhet sipas nenit 11 të Udhëzimit Administrativ nr. 9/2012, për përgjegjësitë dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillave të Veprimit Rinor në Kosovë.

Detyrat

Neni 5

1. Përveç detyrave të parapara sipas nenit 10 të Udhëzimit Administrativ, KVRL ka edhe këto detyra:

- 1.1. Të njoftojë zyrtarin e rinisë për takimet e rregullta;
- 1.2. Të mbështes organizatat anëtare për përgatitje të projekteve dhe aplikimit për fonde;
- 1.3. Të informoj zyrtarin për rini lidhur me projektet e ndryshme të organizatave anëtare.

Përgjegjësitë

Neni 6

1. Përveç përgjegjësiave të parapara sipas nenit 10 të Udhëzimit Administrativ, KVRL ka edhe përgjegjësit në vijim:

- 1.1. Të bashkëpunoj me Këshillat rinor në nivel lokal dhe Këshillin rinor në nivel qendror dhe ndërkombëtar, lidhur me çështjet që ndërlidhen me këshillat rinore.
- 1.2. Organizimin e seminareve, debateve, punëtorive, fushatave vetëdijesuese për çështjet rinore në nivel lokal.
- 1.3. Promovimin dhe zhvillimin e vullnetarizmit.

Funksionimi

Neni 7

1. Funksionimi i KVRL-së bëhet përmes:

1.1. Kuvendit të KVRL-së dhe

1.2. Bordit Drejtues.

2. Kuvendi i KVRL-së përbëhet nga të gjitha organizatat dhe grupet rinore të cilat janë paraparë me Statutin e KVRL-së

3. Bordi Drejtues e ka kryetarin, nënkryetarin, sekretarin dhe anëtarët.

4. Kuvendi ka përgjegjësi për mbajtjen e së paku një takimi vjetor, ku shqyrtohet dhe miratohet raporti për mjetet financiare, detyrimet, të ardhurat, shpenzimet, realizimin e programit të Këshillit për vitin paraprak si dhe planin për mjetet financiare, të ardhurat, shpenzimet dhe programin e Këshillit për vitin vijues.

5. Kuvendi i KVRL-së nuk i delegon detyrat sipas paragrafit 4 të këtij neni:

5.1. Zgjedhjen e zyrtarëve në pozitat udhëheqëse të KVRL-së

5.2. Ndryshimet dhe plotësimet në aktin themelues apo statutin e KVRL-së dhe

5.3. Vendimet për bashkimin, ndarjen, apo shuarjen e KVRL-së

Burimet financiare

Neni 8

1. Mjetet financiare të KVRL-së janë:

1.1. Kontributet nga përfaqësimi i organizatave në KVRL.

1.2. Subvencionet nga të hyrat vetanake të Komunës.

1.3. Subvencionet nga niveli qendror dhe subvencionet nga autoritet ndërkombëtare.

1.4. Donacionet dhe subvencionet nga organizatat tjera , individë apo sponsorë të ndryshëm.

Mbështetja financiare

Neni 9

1. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në pajtim me buxhetin e miratuar të Komunës dhe Planin e Veprimit për Rini, mbulon të gjitha shpenzimet që rezultojnë përkitazi me organizimin e mbledhjes së Kuvendit të KVRL-së, takimeve të kryesisë dhe aktiviteteve rinore.

2. Komuna është përgjegjëse të siguroj lokacion për zhvillimin e aktiviteteve të KVRL-së, të planifikoj buxhet për mbulimin e shpenzimeve për qëndrueshmëri, si dhe mbulon shpenzimet për ushtrimin e aktiviteteve të KVRL-së.

Konflikti i interesit

Neni 10.

1. KVRL aplikon për programe specifike, si:
 - 1.1.Ngritja e kapaciteteve të organizatave anëtare,
 - 1.2.Realizimi i fushave informuese dhe vetëdijesuese,
 - 1.3.Përmirësimi i nivelit të pjesëmarrjes së rinisë në aktivitete,
 - 1.4.Shkëmbimi i përvojave në nivel lokal, qendror dhe ndërkombëtar.
2. Anëtarët e KVRL-së përmbahen nga pjesëmarrja në diskutim , si dhe nga marrja e vendimit apo çështjeve të cekura në pikën 1 të këtij neni, në të cilat ata kanë interes personal ose financiar.
3. Çdo transaksion financiar ndërmjet KVRL-së dhe anëtareve, zyrtarëve ose anëtarëve të Bordit, për çështjen e cekur në paragrafin 1, domosdo duhet të bëhet në vlerën e tregut ose në kushte më të favorshme për KVRL-në.

Procedura e ankesës

Neni 11

KVRL regjistrohet dhe funksionon në pajtim me Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare.

Shpërbërja e KVRL-së.

Neni 12

Shpërbërja e KVRL-së bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për lirinë e asociimit në organizatat jo fitimprurëse.

Zbatimi

Neni 13

Zbatimin e kësaj Rregulloreje e bën Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

III. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Hyrja në fuqi

Neni 14

Rregullorja hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-006-93314
Podujevë,
28 dhjetor 2016

